



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K1/I1-2 Prot.
Nr.doc. 202200042

Tiranë 17.11.2022

Lënda : *Rekomandim për hartimin dhe miratimin e dokumenteve strategjike në nivel vendor, në kuadër të Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025*

BASHKIVE SIPAS QARQEVE

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit tashmë prej kohësh i ka kushtuar vëmendje të veçantë mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të shtresave të cënueshme dhe komuniteteve në risk, në ushtrim të mandatit kushtetues për parandalimin e shkeljes, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Qëllimi e vizioni ynë institucional, por dhe prioriteti i punës sonë në këtë drejtim ka qënë dhe mbetet monitorimi i gjendjes së jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane të vendosura në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe masat e marra për plotësimin e nevojave bazike dhe përmirësimin e qëndrueshëm të jetesës së tyre. Në këtë kuadër, në harkun kohor të pesë viteve të fundit kemi adresuar një sërë rekomandimesh të cilat në thelbin e tyre kanë të bëjnë edhe me sfidat apo problematikat shqetësuese të ndeshura nga minoritetet kombëtare në vend, dhe minoriteti Rom në veçanti.

Gjatë viteve të fundit janë bërë përpjekje e janë ndërmarrë hapa pozitivë nga institucionet shtetërore, si miratimi dhe hyrja në fuqi e Ligjit nr.96/2017 "*Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë*", miratimi dhe zbatimi i dokumentit strategjik, "*Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve, 2016-2020*", me skadimin e të cilit është miratuar edhe *Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025*.

Nga ana tjetër duhet theksuar se, vendi ynë është pjesë e zbatimit të, "Axhendës 2030" të Kombeve të Bashkuara, e cila mbështetet në një bazë të fortë në të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Premtimi kolektiv që, "askush të mos lihet pas", për të eliminuar diskriminimin, reduktuar pabarazitë dhe për të siguruar që objektivat të arrihen për të gjithë me një fokus të veçantë për ata që janë lënë shumë më mbrapa të tjerëve, përbën tashmë prej disa vitesh gurin kilometrik që formëson politika qeveritare dhe pika orientimi, për çdo aktor të rëndësishëm institucional, përfshirë këtu organet e vetëqeverisjes vendore.

Objektivat ambiciozë të cilat qëllimojnë realizimin e, shoqërive të paqta dhe gjithëpërfshirëse, aksesit në drejtësi dhe institucione të përgjegjshëm, zhdukjes së varfërisë dhe pabarazive, si dhe realizimit të dinjitetit njerëzor janë objektiva kyç, pasi natyrshëm përmbushja e tyre sjell reduktim të pabarazisë, barazi gjinore me referenca të qarta ndaj shtresave të marxhinalizuara dhe në risk, ku komunitetet Rome dhe Egjiptiane zënë një vend specifik adresimi.

Megjithatë, angazhimi i kërkuar institucional kërkon një ndërveprim të ngushtë ndërmjet të gjithë aktorëve dhe faktorëve, si në nivelin qëndror të qeverisjes, ashtu edhe në nivelin e vetëqeverisjes vendore, pa përjashtuar në asnjë moment shoqërinë civile me kontributin e saj të vyer. Këto komunitete janë përfaqësuese në nivel vendor të pakicave kombëtare Rome dhe Egjiptiane, ndaj dhe vëmendja jonë e përbashkët do të duhet të fokusohet në disa drejtime kryesore dhe të adresuara në një kuadër më të gjerë në, mbrojtjen e ekzistencës së minoriteteve kombëtare; mbrojtjen dhe promovimin e identitetit të tyre; barazinë dhe mbrojtjen nga diskriminimi si dhe të drejtën e pjesëmarrjes efektive në vendimmarrje, në jetën sociale dhe politike të shoqërisë sonë. Në eksperiencën tonë institucionale kemi konstatuar se, sistemi ynë social formalisht i pranon individët Romë dhe Egjiptianë, por faktikisht i përjashton ata duke u kthyer, në një “pengesë” të pakalueshme, burokratike dhe sinonim të një refuzimi të pashpallur social.

Edhe më sensitive paraqitet gjendja në kushtet e pazakonta të pandemisë së Covid 19, kur përballë nevojës së mbrojtjes së të drejtave të njeriut kanë “ndërhyrë” masa me karakter kufizues të këtyre të drejtave.

Për të adresuar siç duhet këtë realitet, vëmendja jonë e shtuar duhet të drejtohet në disa fenomene të cilat shqetësojnë në vazhdimësi këtë komunitet, si fenomeni i “antixhipsizmit”¹, i strehimit të përshtatshëm, i braktisjes së shkollës, mosfrekuentimit të rregullt të saj, si dhe i krijimit të një ambienti paragjykses dhe pranues në shkollë, për fëmijët Romë dhe Egjiptianë, përjashtimi nga programet e edukimit profesional dhe punësimit aktiv, e një sërë problematikash të tjera sociale dhe ekonomike që tregojnë se nuk kemi bërë mjaftueshëm për minoritetet kombëtare Rome dhe Egjiptiane dhe se, pavarësisht hapave pozitivë të ndërmarrë në këtë drejtim, të gjithë e pranojmë se ka ende shumë për të bërë.

Mbetet ende parësore një qasje e prirur ndaj një reformimi të vazhdueshëm dhe të nevojshëm, të politikave të ndërmarra në këtë fushë të të drejtave të njeriut, e cila kërkon forcimin e vullnetit politik, mekanizmave institucionalë dhe të shoqërisë civile, për të adresuar, monitoruar, luftuar dhe ndëshkuar fenomenin e “antixhipsizmit” në vendin tonë, në çdo nivel që ai shfaqet, si në kuadër të veprimtarisë së pushtetit qëndror, ashtu edhe në atë të vetëqeverisjes vendore.

Me përfundimin e zbatimit të Planit Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve, 2016-2020 është miratuar *Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025*², si një dokument i ri i politikave specifike për integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në dritën e angazhimeve që vendi ynë

¹ I cili shfaqet si manifestim i shprehjeve dhe akteve individuale si dhe i politikave institucionale dhe praktikave të marxhinalizimit, përjashtimit, dhunës fizike, zhvleftësimit të kulturës dhe stilit të jetesës së Romëve, por edhe në gjuhën e urrejtjes të drejtuar ndaj Romëve.

² Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 701 datë 18.11.2021.

ka marrë përsipër në rrugën e integrimit Evropian. Ai është një dokument i rëndësishëm strategjik në nivel qendror që përbën një përpjekje për të siguruar vazhdimësinë politikave që nxisin integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve, shëmbjen e barrierave më të cilat ata përballen, aksesin në shërbime, përmirësimin e kushteve të jetesës dhe dialogun ndërkulturor. Masat e parashikuara nga ky plan orientohen në fusha të tilla si barazia, aksesin në drejtësi, regjistrimi civil, strehimi, kujdesi shëndetësor, arsimit, dialogu ndërkulturor, punësimi dhe përmirësimi i aftësive dhe mbrojtja sociale.

Në këtë dokument të rëndësishëm të politikave në nivel qendror, njesive të vetqeverisjes vendore u është atribuar një rol i rëndësishëm, duke përcuar frymën e bashkëpunimit nga këto institucione si struktura të cilat duhet të luajnë një rol edhe më praktik dhe specifik bazuar në përgjegjësitë dhe fushën e zgjeruar të veprimtarisë së tyre, të mbështetur tek parimi i decentralizimit dhe reforma e administrimit territorial.

Nën dritën e këtij kuadri të ri strategjik, për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrje, duhet të projektohet edhe vizioni i ri, që krahas luftës ndaj “antixhopsizmit”, të hartohen politika konkrete integrimi dhe përfshirjeje reale të Romëve dhe Egjiptianëve, specifikisht edhe në nivelin e vetqeverisjes vendore, për t’i bërë ata të ndihen pjesë e një shoqërie me diversitet, gjithëpranuese dhe demokratike.

Bashkitë, si njësi të vetqeverisjes vendore duhet të luajnë një rol më proaktiv në këtë fushë, pasi ato duhet të udhëhiqen në veprimtarinë e tyre, nga parimi i autonomisë vendore, në përputhje me legjislacionin në fuqi, parim i cili në pikën 2, të nenit 2, të Ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, i ndryshuar, përkufizohet si;

“...e drejta dhe aftësia e njesive të qeverisjes vendore, të krijuara sipas Kushtetutës dhe këtij ligji dhe në kuadër të kufizimeve të tij, që të rregullojnë dhe të administrojnë një pjesë thelbësore të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të bashkësisë”.

Sikurse përcaktohet shprehimisht në pikën 1, të nenit 8, të ligjit “Për vetqeverisjen vendore”, i ndryshuar:

“Organet e njesive të vetqeverisjes vendore mund të ndërmarrin nisma me interes publik vendor në territorin e juridiksionit të tyre për çdo çështje që nuk u ndalohet me ligj, ose që nuk i është dhënë ekskluzivisht me ligj një organi tjetër shtetëror”.

Me vizionin e shprehur në dokumentet kryesorë strategjikë ndërkombëtarë³, që synojnë dhe projektojnë politika konkrete integrimi dhe përfshirjeje reale të Romëve dhe Egjiptianëve, dhe në përputhje dhe zhvillim të mëtejshëm të objektivave që përcaktohen në dokumentet strategjike të politikave tona shtetërore të hartuara nga organet e qeverisjes qendrore për këtë qëllim, do të duhet që ju si njësi të vetqeverisjes vendore, të keni dhe hartoni një koncept strategjik, të përshtatur me kushtet tuaja specifike vendore të arritjes së objektivave madhore shtetërore.

Ashtu si institucioni i Avokatit të Popullit e ka adresuar dhe më herët nëpërmjet rekomandimeve drejtuar Bashkive, ky vetëveprim proaktiv është i nevojshëm dhe do të mund të realizohet përmes hartimit dhe *miratimit të planeve rajonale të veprimit, për*

³ Strategjia e Bashkimit Evropian për Romët, 2020-2030, e cila synon reduktimin e dukshëm të përjetimit të diskriminimit, mundësimin e shtuar të raportimit të diskriminimit kur ai ndodh, reduktimit të varfërisë tek Romët (dhe Egjiptianët për kushtet tona), pjesëmarrjen e shtuar në arsimin të fëmijëve Romë (dhe Egjiptianë), reduktimin e segrimit në shkolla, nxitjen e punësimit me fokus edhe punësimin gjinor, rritjen e mundësisë për strehim, rritjen e furnizimit me ujë të pijshëm dhe rritjen e pritshmërive që lidhen me cilësinë e jetesës.

integrimin e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, të cilat jetojnë në njësitë administrative territoriale, që administrohen nga ana juaj si bashki. Kjo mënyrë mendimi dhe veprimi sa më afër qytetarëve, rrit vlerat e sistemit vetëqeverisës vendor dhe efektivisht rrit mundësinë e zbatimit të politikave integruese, në përshtatje me kushtet specifike të çdo njësie të vetëqeverisjes vendore.

Planet rajonale të integritit të Romëve dhe Egjiptianëve, përfaqësojnë një kërkesë dhe nismë të qënësishme si dhe të nevojshme për t'u realizuar nga ana juaj, për të vendosur një standard të ri, më të lartë, të vlerësimit dhe adresimit të nevojave dhe zgjidhjeve të ofruara, ndaj pritshmërive që komunitetet Rome dhe Egjiptiane kanë ndaj veprimtarisë së organeve të vetëqeverisjes vendore. Në kuadër të agjendës së integritit të vendit tonë në Bashkimin Evropian, zhvillimi i këtyre politikave në nivel vendor ka një rol shumë të rëndësishëm, për të kuptuar dhe zbatuar procesin e integritit në nivel kapilar, në njësitë e vetëqeverisjes vendore, përkatësisht në bashki.

Shembulli ekzistues i disa bashkive, që kanë hartuar, miratuar dhe zbatuar planet e tyre rajonale të zhvillimit të komuniteteve përkatëse Rome dhe Egjiptiane, duhet të shërbejë si një shembull i mirë, për të vazhduar dhe përmirësuar këtë frymë qasjeje ndaj problematikave të shtruara për zgjidhje, për integrimin real të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, në të gjitha bashkitë e vendit tonë.

Nga ana tjetër, është shumë e rëndësishme që këto plane jo vetëm të jetë efektivisht të miratuar e në fuqi, por edhe të realizohet monitorimi real i zbatimit të tyre, për të matur ecurinë në nivel lokal të uljes së pabarazisë në këto komunitete. Kjo mund të realizohet duke parashikuar mekanizma të dedikuar për monitorimin e këtyre planeve, për të raportuar periodikisht mbi fushat prioritare, qëllimet strategjike, objektivat e treguesit e këtyre planeve të veprimit.

Mbi këtë bazë vlerësimi, në përputhje me përcaktimin e dhënë në paragrafin e parë, të nenit 2, të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet shprehimisht se:

“Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj. Ai është nxitës i standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend”,

REKOMANDOJMË

Hartimin dhe miratimin e dokumenteve strategjike në nivel vendor (planeve vendore të zhvillimit), nga ana juaj si njësi të vetëqeverisjes vendore, me qëllim përcaktimin e objektivave dhe parashikimin e marrjes së masave konkrete, në përputhje me bazën ligjore ekzistuese në fuqi, në frymën e luftës ndaj “antixhipsizmit” dhe për realizimin e procesit të integritit real të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, që jetojnë në territorin administrativ të administruar nga ana juaj.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, lutemi të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj, ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj,

KOMISIONERI

Vilma SHURDHA